



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0190**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " RENER " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1, me 16/04/2026, mori:

### Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE " RENER " SH.P.K., me nr. 2026/0190, e datës 27/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E-Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E-Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " RENER " SH.P.K.

### Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.09.2025 MINISTERIA E SHËNDETËSISË.,duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, “Mirembajtja dhe Avancimi i Sistemit të E-Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shendetesore (HIFIS)” me nr. të prokurimit: "206-25-7982-2-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 127,000.00 €.

Me 19.11.2026 MINISTERIA E SHËNDETËSISË.,duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “Cactus SH.A.

Me 17.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 23.03.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.03.2026 “RENER SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokollit 2026/0190, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhenje të kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RENER SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 23.03.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim pa u trajtuar konkretisht pretendimet tona ankimore, por vetëm duke u dhënë një arsytim i përgjithshëm se “procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit”. Njëkohësisht, kjo ankesë parashtrohet edhe kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 13.03.2026.

Me vendimin e datës 23.03.2026, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik, pasi nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar veçmas pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim. Të gjitha pikat e kërkesës për rishqyrtim kundër vendimit për dhënien e kontratës të datës 13.03.2026 mbesin të njëjta dhe po i parashtrojmë më poshtë.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, për shkak se ka vlerësuar si të përgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ndonëse e njëjta është e papërgjegjshme në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Kjo për arsye se: a) AK e ka pranuar si certifikim ekuivalent me PMP certifikatën PRINCE2 Foundation; dhe b) AK e ka cilësuar si të mjaftueshme përvojën e punës së Menaxherit të Projektit në kohëzgjatje prej vetëm 3 vjet e 4

muaj, ndonëse kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e qartë për minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Në Dosjen e Tenderit, te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional 9.1 dhe 9.2, në pozicionin a) të pikës 3, është kërkuar shprehimisht: “Një Menaxher Projekti me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), i certifikuar me certifikatë valide PMP ose ekuivalente.”

Në këtë rast, OE “Cactus” Sh.a., i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar certifikatën PRINCE2 Foundation, e cila nuk mund të konsiderohet ekuivalente me PMP. Kjo për arsye se PMP është një certifikim i nivelit profesional që kërkon minimum 3 deri në 5 vite përvojë në udhëheqje dhe menaxhim projektesh të dokumentuar para se kandidati t’i nënshtrohet testimit, ndërsa PRINCE2 Foundation është certifikim i nivelit fillestar (“entry-level”) që vërteton vetëm njohjen e terminologjisë dhe mund të merret pa asnjë ditë përvojë pune. Në industrinë e TIK-ut, ekuivalenti real i PMP është PRINCE2 Practitioner, ndërsa barazimi i një certifikate bazike si PRINCE2 Foundation me një certifikim profesional si PMP përbën devijim material nga kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe bie ndesh me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së.

Kjo për shkak se, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, në pikën 3, është kërkuar qartë një Menaxher Projekti me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, konkretisht në projekte të zhvilluara në .NET dhe SQL Server. Pranimi i PRINCE2 Foundation, e cila nuk kërkon përvojë pune, bie në kundërshtim me vetë kërkesën për 5 vite përvojë pune specifike në projekte të natyrës së ngjashme në fushën e inxhinierisë softuerike. Një menaxher projekti me PRINCE2 Foundation, certifikatë që mund të merret pas një trajnimit të shkurtër dhe pa përvojë pune paraprake, nuk mund të konsiderohet ekuivalent me një menaxher projekti të certifikuar me PMP për një projekt që kërkon përvojë specifike në .NET dhe SQL Server.

Po ashtu, AK ka dështuar të bëjë vlerësimin korrekt të ekuivalencës së certifikimeve në kuadër të metodologjive ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve si PMI, PRINCE2 dhe IPMA, të cilat mund të njihen si korniza të barasvlershme në kuptim të përgjithshëm profesional, por jo në kuptimin që çdo nivel certifikimi brenda tyre është automatikisht ekuivalent. Pikërisht për këtë arsye, PRINCE2 Foundation nuk mund të trajtohet si ekuivalente me PMP, sepse është nivel fillestar (“entry-level”) që vërteton vetëm njohjen e terminologjisë dhe mund të merret pa asnjë ditë përvojë pune, ndërsa PMP është certifikim profesional që kërkon minimum 3 deri në 5 vite përvojë në udhëheqje dhe menaxhim projektesh të dokumentuar para se kandidati t’i nënshtrohet testimit.

Në një analogji me sistemin e Bolonjës, është kërkuar Master shkencor (nga Universiteti i Prishtinës) ose ekuivalent me të, ndërsa Operatori Ekonomik ka ofruar Bachelor nga një universitet tjetër. Prandaj, është e qartë se PRINCE2 Foundation (si Bachelor) nuk është ekuivalent me PMP (si Master shkencor).

Në të njëjtën kohë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur as kërkesën lidhur me përvojën minimale të punës për Menaxherin e Projektit, pasi AK ka pranuar përvojë pune prej vetëm 3 vjet e 4 muaj, ndonëse kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë shprehimisht për minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Prandaj, oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e përgjegjshme në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit, sepse nuk e përmbush as kriterin për certifikim valid PMP ose ekuivalent, e as kriterin për minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit për Menaxherin e Projektit. Rrjedhimisht, vendimi i AK-së për ta vlerësuar këtë ofertë si të përgjegjshme dhe për ta rekomanduar për kontratë është marrë në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, si dhe në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë nga neni 7 i LPP-së, pasi janë pranuar si të mjaftueshme dëshmi që nuk i përmbushin standardet dhe kërkesat e përcaktuara shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe konstatojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara, andaj si AK-MSh mbesim pas vendimit të datës 13.03.2026. Në lidhje me pretendimet tuaja, Komisioni i rivlerësimit ka rekomanduar si në vijim: pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe pas analizimit të plotë të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Vlerësimit konstaton se procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2025-1214, dt. 10.02.2026, me të cilin është aprovuar ankesa e Operatorit Ekonomik “Cactus” Sh.a. dhe procedura është kthyer në rivlerësim për herë të dytë, Komisioni ka kryer një rivlerësim të plotë të të gjitha ofertave të pranuar në këtë procedurë. Gjatë këtij rivlerësimi janë analizuar të gjitha elementet e ofertave në raport me kriteret administrative, teknike dhe financiare të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Si rezultat i këtij procesi, Komisioni ka konstatuar se oferta e Operatorit Ekonomik “Cactus” Sh.a., Prishtinë, është ofertë e përgjegjshme, pasi i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit. Po ashtu, kjo ofertë rezulton të jetë oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme të pranuar në këtë procedurë. Në këto rrethana, Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik “Cactus” Sh.a., në përputhje me kriterin e dhënies së kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ne, si AK, pas rivlerësimit e kemi shpërblyer me kontratë ofertën e “Cactus” Sh.a. nga Prishtina, si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë, e cila i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga NJK dhe DT, duke zbatuar edhe vendimin e OSHP-së nr. 2025/1214 të datës 18.02.2026, i cili i ka dhënë të drejtë OE ankues “Cactus” Sh.a. dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Duke marrë parasysh faktin që lënda është trajtuar me ankesë në OSHP, bazuar në konstatimet e dhëna nga Paneli Shqyrtues në vendimin nr. 2025/1214, pas rivlerësimit është shpërblyer me kontratë oferta e operatorit ekonomik “Cactus” Sh.a. nga Prishtina në vlerën 39,369.96 €, ndërkohë që oferta juaj ka qenë 78,840.00 €. Ne, si AK-MSh, herën e parë ju kemi shpallur fitues me B58 – Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 19.11.2025.

Si përfundim, në bazë të sqarimeve të lartcekura, nuk kemi diskriminuar apo favorizuar asnjë OE, por sipas kriterëve të kërkuara në NJK dhe DT, si dhe në përputhje me vendimin e OSHP-së nr. 2025/1214 të datës 18.02.2026, kemi përzgjedhur ofertën e përgjegjshme me çmimin më të

lirë, e cila sipas Komisionit të Vlerësimit i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas NJK dhe DT.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0190, ndërsa me datë 07.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0190, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “RENER SH.P.Keksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0190 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimet ankimore të cilat i takojnë karakterit teknik janë shqyrtuar nga eksperti teknik dhe përgjigjet janë si më poshtë.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit, duke vlerësuar gabimisht se certifikatat e ofruara "PRINCE2 7 Foundation" është ekuivalente me kërkesën për certifikim "PMP".

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti teknik lidhur me këtë pretendim ankimor sqaron se në ankesën paraprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Paneli Shqyrtues i OSHP ka vendosur sipas vendimit me numër 1214/25, të datës 18.02.2026, ku ka vendosur që aktivitetin ta kthen në rivlerësim.

Në vendim, përkatësisht në gjetjet e Panelit, lidhur me çështjen kontestuese thuhet “Megjithate, Paneli shqyrtues vlerëson se në këtë rast nuk mund ta mbështesë në tërësi asnjërin raport, nisur nga neni 7 i LPP, trajtimi i barabartë, për shkak se, të dyja kanë ndryshime të mëdha dhe konsideron se lidhur me këtë AK konform nenit 59 të LPP të kërkon drejtpërdrejtë sqarime nga organet të cilat i kanë lëshuar këto certifikata, me qëllim të konstatojnë drejtë se këto certifikata të ankuesit a e plotësojnë kërkesën e Dosjes së Tenderit. Së dyti, Paneli Shqyrtues pa një

vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe reale nuk e merr mbi sipër përgjegjësinë që të pranoj certifikata tjera të cilat nuk janë adekuate për implementimin e këtij projekti, ngase, mund të ketë pasoja dhe rreziqe gjatë realizimit. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues vendos që të anulohet njoftimin mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS)” me nr. të prokurimit: 206-25-7982-2-1-1., iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe lëndën ta kthejë në ri-vlerësim dhe AK të veprojë konform udhëzimeve të dhëna nga ky Panel Shqyrtues.”

Sipas shkresave të lëndës, pas vendimit të OSHP-së numër 1214/25, AK ka bërë rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, dhe nuk ka evidencë që është kërkuar sqarime shtesë lidhur me certifikata ashtu sikurse përcaktohet në vendim.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka dhënë përgjigjen përgjithëse si vijon: “Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe pas analizimit të plotë të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Vlerësimit konstaton se procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2025 - 1214, dt.10.02.2026, me të cilin është aprovuar ankesa e Operatorit Ekonomik " Cactus " Sh.a. dhe procedura është kthyer në rivlerësim për herë të dytë, Komisioni ka kryer një rivlerësim të plotë të të gjitha ofertave të pranuar në këtë procedurë. Gjatë këtij rivlerësimi janë analizuar të gjitha elementet e ofertave në raport me kriteret administrative, teknike dhe financiare të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Si rezultat i këtij procesi, Komisioni ka konstatuar se oferta e Operatorit Ekonomik " Cactus " Sh.a., Prishtinë, është ofertë e përgjegjshme, pasi i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit. Po ashtu, kjo ofertë rezulton të jetë oferta me çmimin më të ulët, ndër ofertat e përgjegjshme të pranuar në këtë procedurë. Në këto rrethana, Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik " Cactus " Sh.a., në përputhje me kriterin e dhënies së kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit.”

Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 1

Lidhur me këtë çështje, vendimi 1214/2025 i OSHP-së kthen aktivitetin në rivlerësim duke ndjekur udhëzimet e dhëna në vendim që AK konform 59 të LPP të kërkon drejtpërdrejtë sqarime nga organet të cilat i kanë lëshuar këto certifikata, me qëllim të konstatojnë drejtë se këto certifikata të ankuesit a e plotësojnë kërkesën e Dosjes së Tenderit. Mirëpo, AK, gjithmonë sipas shkresave të lëndës nuk ka vepruar në përputhje me vendimin e OSHP-së, duke mos kërkuar sqarime shtesë. Eksperti teknik rithekson se sikurse është përshkruar në raportin numër 1214/25 të datës 10.02.2026, dallimi ndërmjet kërkesës për certifikim PMP dhe dëshmimeve të paraqitura nga OE (PRINCE2 Foundation) nuk është thjesht në emërtim, por në nivelin e kualifikimit dhe kompetencës profesionale. PMP përfaqëson një nivel profesional që kërkon përvojë praktike disa vjeçare në menaxhimin e projekteve, ndërsa PRINCE2 Foundation është nivel fillestar që dëshmon vetëm njohuri teorike dhe jo aftësi për menaxhim të pavarur të projekteve. Niveli më i afërt me PMP do të ishte PRINCE2 Practitioner. Po ashtu, certifikata ITIL Foundation nuk lidhet me menaxhimin e projekteve, por me menaxhimin e shërbimeve të TI-së, prandaj nuk mund të konsiderohet ekuivalente me kërkesën. Si rrjedhojë, OE nuk ka arritur të provojë ekuivalencën e certifikimeve të paraqitura me kërkesën e AK-së, dhe për këtë arsye eliminimi i ofertës së tij konsiderohet i drejtë dhe në përputhje me kushtet e tenderit. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

## Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 59 të LPP-së duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm, i cili nuk ka përmbushur kriterin specifik të Dosjes së Tenderit për përvojën profesionale të Menaxherit të Projektit (5 vite pas diplomimit në teknologjitë .NET dhe SQL Server). Sipas ankuesit, AK ka pranuar gabimisht një përvojë prej vetëm 3 vjet e 4 muajsh, duke dështuar në zbatimin e kriteret gjatë vlerësimit dhe duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë në garë.

## Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2

AK në dosjen e tenderit ne lidhje me këtë kriter ka qenë si ne vijim: “1 (një) Menaxher të projektit- Bachelor i shkencave kompjuterike ose inxhinierisë kompjuterike ose telekomunikacion, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), i certifikuar me certifikatë valide në PMP ose ekuivalente”. Ndërsa dëshmia dokumentare e kërkuar ishte: “Dëshmite 3 (a,b,c): Kopje e diplomës, CV, Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, Kopjen e certifikatës për menaxhim dhe vegëzën përkatëse për verifikim online.”

OE ankues ne ofertën e tij ka prezantuar listën e stafit, ku për pozitën Menaxher i projektit, në dokumentin me emërtimin “5. Lista dhe Dokumentet e stafit.pdf”, faqe 1, ka propozuar personin M\* P\*-K\*, ku për të njëjtën është dorëzuar CV (faqe 4-8) dhe ku përshkruhet përvoja e saj relevante si Menaxhere Projekti në kompaninë CACTTUS SH.A. fillon zyrtarisht më datë 24/08/2020, ndërsa tek lista e projekteve prezantohen informatat për angazhimin e saj si menaxhere e projektit, në projektet: “The Design and Development of a Legal Information Service (LawData) for the Kosovo Assembly (2020–2023)” dhe “E-Solutions to Improve Taxpayer Services for the Tax Administration of Kosovo (2023–2024)”.

## Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 2

OE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të vërtetojë se Menaxheri i Projektit plotëson kriterin e kërkuar prej 5 viteve (60 muaj) përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme (.NET dhe SQL Server). Megjithëse kandidatja ka diplomuar në vitin 2017, përvoja e saj relevante si Menaxhere Projekti në kompaninë “CACTTUS SH.A” fillon zyrtarisht më datë 24/08/2020. Duke marrë për bazë periudhën prej 4 vjet e 4 muaj, e cila përkon me periudhën nga 24/08/2020 deri në fund të dhjetorit 2024 (nëse merret për bazë afati maksimal 31 dhjetor 2024) rezulton se kandidatja ka saktësisht 52 muaj përvojë relevante. Për rrjedhojë, përvoja e dëshmuar përmes dëshmisë dokumentare (CV) nuk përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit të specifikuar nga AK prej 5 vite (me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)). Rrjedhimisht, vendimi i AK-së për ta vlerësuar këtë ofertë si të përgjegjshme është në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, pasi dëshmitë dokumentare nuk mbështesin plotësimin kërkesës së përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirembajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shendetesore (HIFIS)” me nr. të prokurimit: "206-25-7982-2-1-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështjeje ja fal besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënje të kontrates dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - " RENER " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: